

Vendim nr. 274 datë 29.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 29.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 40 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ADRIANA LOKU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 13-2015-4042 (888), datë 06.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2016-1636 (698), datë 18.07.2016 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-609, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 18, 33, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Adriana Loku, sipas vendimit noterial të datës 03.08.2020, është një nga trashëgimtarët testamentarë të shtetases F.M.(Ç.), e cila ka ndërruar jetë në datën 25.06.2020. Kjo e fundit ka qenë një nga trashëgimtarët e babait të saj Xh.Ç. Këtij shtetasi (trashëgimtarëve) dhe motrës së tij M.Ç.(P.), me vendimin nr. 103/2, datë 27.11.1993 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Elbasan, u është njohur dhe kthyer në natyrë një banesë 2-katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 104 m² dhe oborr 48 m², e ndodhur në qytetin e Elbasanit. Për këtë pasuri, sipas një aktmarrëveshjeje të datës 06.12.1994, trashëgimtarët e Xh.Ç. dhe shtetasja M.Ç.(P.), si bashkëpronarë të pasurisë, kanë bërë ndarjen vullnetare të saj. Pas kësaj, shtetasja M.Ç.(P.), atë pjesë të banesës dhe të oborrit, lënë asaj në pronësi, me kontratën e datës 17.05.1995, ia ka shitur shtetasit P.P., nipit të bashkëshortit të saj.

2. Mbi një padi të trashëgimtarëve të Xh.Ç., me vendimin nr. 1153, datë 02.11.1999, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka deklaruar të pavlefshme aktmarrëveshjen për ndarjen vullnetare të pasurisë, duke urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme me arsyen se ajo është e falsifikuar.

3. Po për një padi të trashëgimtarëve të Xh.Ç., me vendimin nr. 1368, datë 21.11.2001, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka deklaruar absolutisht të pavlefshme edhe kontratën e shitjes së datës 17.05.1995 të lidhur mes shtetases M.Ç.(P.) dhe shtetasit P.P., duke urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 123, datë 04.03.2002, me plotësimin që shtetasi P.P. t'i lirojë banesën e blerë shtetases M.Ç.(P.), pasi kjo e fundit t'i ketë kthyer çmimin e shitjes (5.000.000 lekë), duke llogaritur indeksin e zhvleftësimit të lekut në momentin e ekzekutimit të vendimit. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 942, datë 05.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të shtetasit P.P. Vendimi gjyqësor në këtë rast është regjistruar në regjistrat e hipotekës.

4. Në vijim, trashëgimtarët e Xh.Ç. kanë kërkuar gjyqësisht pjesëtimin e pasurisë. Në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 1132, datë 14.07.2003, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur dhënien fund të bashkëpronësisë mes palëve ndërgjyqëse dhe e ka ndarë në natyrë pasurinë mes trashëgimtarëve të Xh.Ç. dhe shtetases M.Ç.(P.), duke përcaktuar pjesët përkatëse të

banesës dhe të oborrit të saj për secilën palë ndërgjyqëse. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 43, datë 10.02.2004.

5. Ndërkohë, me kontratën noteriale të shitjes të datës 28.02.2003, bashkëpronarët trashëgimtarë të Xh.Ç. u kanë shitur pasurinë e tyre (atë pjesë të banesës dhe oborrit të saj të lënë atyre në pronësi) shtetasve A.Ç. dhe F.Ç. Po kështu, me deklaratën noteriale të datës 18.05.2004, ata kanë deklaruar dakordësinë e tyre që pasuria nr. 11/263, zona kadastrale 8522, për të cilën bënte fjalë vendimi i formës së prerë nr. 1132, datë 14.04.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, të regjistrohet në emër të shtetasit A.Ç., pasi këtë pronë ia kanë shitur atij me kontratën noteriale të lartpërmendur, duke saktësuar sipërfaqen e truallit nën banesë dhe të oborrit (pjesën përkatëse të saj). Në vijim, kjo pronë është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Elbasan në favor të blerësve A.Ç. dhe F.Ç.

6. Në datën 03.06.2009 shtetasja M.Ç.(P.) ka ndërruar jetë. Me vendimin nr. 2276, datë 07.11.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerën M.Ç.(P.), duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së tretë fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç. Këta të fundit, në vijim, kanë regjistruar në emër të tyre pasurinë, pjesën përkatëse të banesës dhe të oborrit që figuronte në emër të së ndjerës M.Ç.(P.) dhe më pas, me kontratën noteriale të shitjes së datës 27.04.2012, këtë pasuri ua kanë shitur sërish shtetasve A.Ç. dhe F.Ç., të cilët, në vijim, duke konsideruar se janë bërë pronarë të ligjshëm tashmë të të gjithë banesës dhe të oborrit të saj, kanë marrë leje ndërtimi për rikonstruksionin e saj, përveçse e kanë vendosur pasurinë edhe si garanci hipotekare për marrje kredie bankare.

7. Nga ana tjetër, sipas një testamenti noterial të datës 03.12.1993, shtetasja M.Ç.(P.) ka disponuar pasurinë e saj pas vdekjes në favor të shtetasit P.P., nipit të bashkëshortit të saj, për kërkesën e të cilit, me vendimin nr. 1056, datë 25.04.2012, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare për testatoren M.Ç.(P.), duke përcaktuar shtetasin P.P. si trashëgimtar të vetëm testamentar për të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj, sikundër edhe për detyrimet që rrjedhin nga trashëgimia. Bazuar në dëshminë e trashëgimisë testamentare shtetasi P.P. ka kërkuar regjistrimin në emër të tij të pasurisë që figuronte në emër të së ndjerës M.Ç.(P.), gjë e cila është refuzuar nga ZRPP-ja, Elbasan për shkak se pasuria e së ndjerës ishte regjistruar tashmë sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar me vendimin nr. 2276, datë 07.11.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

8. Ndërkohë, ndërsa shtetasi P.P. vijonte të mbante pasurinë tashmë me pretendimin e qenies trashëgimtar testamentar i pronares M.Ç.(P.), shtetasi M.Ç., vëllai i trashëgimlënësës së kërkueses, në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës M.Ç.(P.), ka ngritur padi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit dhe detyrimin e shtetasit P.P. për të njohur si trashëgimtarë të M.Ç.(P.) të gjithë personat, fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç., të përcaktuar në vendimin gjyqësor për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të saj, përfshirë edhe trashëgimlënësen e kërkueses. Ai ka pretenduar se testamenti ishte absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 406 të Kodit Civil (KC), për shkak se ishte në kundërshtim me nenin 377 të tij, në kushtet kur testatorja ka disponuar pasurinë jashtë rrethit të personave të përcaktuar në këtë dispozitë, ndonëse ka lënë pas fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç.

9. Me vendimin nr. 888, datë 06.07.2015, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur detyrimin e të paditurit P.P. të njohë paditësin M.Ç. me pjesëtarë (të cilësuar sipas vendimit të saj nr. 2276, datë 07.11.2011), si të vetmit trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës M.Ç.(P.), si dhe detyrimin e tij (të paditurit) për t'i njohur ata trashëgimtarë të së ndjerës për pasurinë banesë dhe të oborrit të saj (pjesës përkatëse). Ndër të tjera, ajo gjykatë ka arsyetuar se nga interpretimi harmonik i neneve 360, 361, 362, 363, 364, 374 dhe 377 të KC-së, arrihet në përfundimin se mund të përfitojnë nga trashëgimia me testament fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, personat e paaftë për punë, vëllezërit dhe motrat, gjyshi, gjyshja, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur, pra trashëgimtarët ligjorë të tre radhëve të para, dhe kur këta mungojnë, pasuria mund t'u lihet trashëgimtarëve ligjorë të radhëve të tjera dhe çdo personi tjetër fizik ose juridik edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Në rastin konkret, testatorja M.Ç.(P.) ka cenuar kufizimin ligjor të lirisë së disponimit me testament, për sa kohë që ka caktuar si trashëgimtar testamentar nipin e burrit të saj, të paditurin P.P., i cili nuk përfshihet në rrethin e atyre trashëgimtarëve ligjorë të cilëve mund t'u lihet pasuria trashëgimore, si me testament, ashtu edhe me trashëgimi ligjore sipas radhëve, përveçse, për më tepër, testatorja në kohën e vdekjes së saj ka lënë pas fëmijët e vëllait të paravdekur, një ndër të cilët edhe paditësi M.Ç. Për rrjedhojë, disponimi me testament në rrethana të tilla bie në kundërshtim me nenin 377 të KC-së, duke qenë testamenti absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 406 të po këtij kodi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i padituri P.P.

10. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2016-1636 (698), datë 18.07.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se rrethi i

personave që gëzojnë mbrojtje nga neni 377 i KC-së është i përcaktuar në mënyrë shteruese dhe çdo interpretim i zgjeruar dhe i përzier i normave është i gabuar, si dhe në tejkalim të ligjit. Sipas saj, në rastin konkret, paditësi M.Ç. me pjesëtarë nuk përfshihen në rrethin e personave të përmendur në nenin 377 të KC-së, ndaj ata nuk mund të gëzojnë mbrojtje juridike nga kjo dispozitë, duke bërë që testamenti i testatores M.Ç.(P.), përballë pretendimit të paditësit, të jetë i vlefshëm dhe në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe paditësi M.Ç.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-609, datë 12.02.2025, ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të paditësit M.Ç., me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Ai kolegji ka vlerësuar se nga ana e gjykatës së apelit janë respektuar normat procedurale që mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, ndërkohë që nuk rezulton të kishte shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve, përveçse nga ajo gjykatë janë respektuar drejt dispozitat e ligjit material dhe vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me praktikën e atij kolegji ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Në datën 31.07.2025 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar procesin gjyqësor të vënë në lëvizje me padinë e shtetasit M.Ç., për pavlefshmërinë absolute të testamentit të lënë nga trashëgimlënësja M.P.(Ç) dhe detyrimin e shtetasit P.P. për të njohur si trashëgimtarë të saj fëmijët e vëllait Xh.Ç., përfshirë edhe të trashëgimlënësës së kërkujes.

13. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkujes

14. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 14.1. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit*, pasi gjykatat kanë keqzbatuar e për më tepër kanë interpretuar paligjshmërisht, në të kundërt, vendimin unifikues nr. 19, datë 15.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 19/2002*) dhe nenin 349 të KC-së në raport me pasurinë e trashëguar e për më tepër të regjistruar në regjistrin hipotekar. Edhe pse gjykatat e faktit kanë dhënë dy vendime diametralisht të kundërta në lidhje me interpretimin e nenit 377 të KC-së, Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar funksionin si gjykatë e ligjit edhe për kontrollin e respektimit të së drejtës për proces të rregullt, duke mos konstatuar dhe riparuar shkeljet e kryera nga gjykata e apelit.
- 14.2. *Së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në gjykim nuk është thirrur trashëgimlënësja e kërkueses, shtetasja F.M.(Ç.), e cila ka fituar të drejtat e njohura sipas vendimit nr. 766/2012. Trashëgimia ligjore e M.P.(Ç.) është kërkuar dhe çelur nga trashëgimlënësja e kërkueses nëpërmjet vendimit nr. 2276/2011 dhe jo nga paditësi M.Ç., që në atë proces nuk ka qenë palë ndërgjyqëse dhe në procesin e kundërshtuar nuk ka pasur tagra dhe as nuk është njohur si përfaqësues ligjor për të mbrojtur të drejtat e fituara e të njohura edhe gjyqësisht të trashëgimtarëve të tjerë. Sipas vendimit unifikues nr. 19/2002, padia për kërkimin e trashëgimit ngrihet nga trashëgimtari të cilit i është cenuar tërësisht ose pjesërisht e drejta trashëgimore, kundër personave që e mbajnë atë si trashëgimtarë, ndaj mosndërtimi i rregullt i ndërgjyqësisë e bën gjykimin të parregullt. Edhe referuar relacionit të këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë, të vetmit që kanë legjitimitet për të ngritur padi janë personat e tretë në gjykim, pasi ata kanë titullin e pronësisë, të cilët duhet të thërrisnin si ndërhyrës dytësorë edhe trashëgimtarët ligjorë të M.P.(Ç.), prej nga e kanë edhe origjinën e pronës objekt shqyrtimi. Ndërkohë që as F.M.(Ç.) por edhe trashëgimtarët e tjerë nuk rezulton të jenë thirrur si palë ndërgjyqëse, çka është atribut edhe i gjykatës në bazë të nenit 193 të KPC-së. Formimi drejt i ndërgjyqësisë përbën kusht të domosdoshëm për rregullsinë e procesit gjyqësor, pasi ai lidhet me parimin e kontradiktoritetit në gjykim dhe të barazisë së armëve. Në procesin gjyqësor janë thirrur si palë ndërgjyqëse edhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-ZVRPP-ja), Elbasan dhe shtetasit A.Ç. e F.Ç., por nuk janë thirrur

trashëgimtarët e tjerë të trashëgimlënësës M.P.(Ç.), të cilët e kanë pasur të regjistruar pronën e trashëguar, pra që kishin kaluar në emrin e tyre pasurinë e së ndjerës.

14.3. Nëse trashëgimtarët e M.P.(Ç.) do të ishin thirrur në gjykimin në fakt, ata do të kërkonin pushimin e çështjes, pasi pozita juridike e palëve është *gjë e gjykuar*, e shprehur dhe e pranuar, ndonëse shkaqet ligjore e provat se përse testamenti në favor të shtetasit P.P. është absolutisht i pavlefshëm janë të shumta e të mbështetura edhe në akte e praktika gjyqësore. Po kështu, ata do të kërkonin përpara gjykatës së apelit përjashtimin e gjyqtarëve P.C. dhe A.F., që në bazë të vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishin caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në procesin gjyqësor paraardhës, ku ishte dhënë vendimi nr. 63, datë 29.01.2016 i Gjykatës së Apelit Durrës për pretendimin e shtetasit P.P. për trashëgiminë e së ndjerës M.P.(Ç.) përmes testamentit enigmatik e kontradiktor në favor të tij. Këta dy gjyqtarë kanë dhënë plotësim vendimi të vendimit nr. 123, datë 04.03.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës për një detyrim stratosferik financiar në favor të P.P., duke qenë të papranueshëm për të gjykuar çështjen. Po kështu, në procesin në Gjykatën e Lartë do të ishte kërkuar përjashtimi i trupit gjykues, që në shkelje të hapur e në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 9, datë 03.06.2024 ka gjykuar jashtë rendit kronologjik dy çështje gjyqësore, duke gjykuar në mënyrë të pajustificueshme edhe proceduralisht më përpara çështjen gjyqësore nr. 11243-03844-00-2016, datë regjistrimi 01.12.2016.

14.4. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara*, pasi trashëgimlënësja F.M.(Ç.) e kërkuesses tërheq të drejta pronësie si trashëgimtare ligjore e shtetasës M.P.(Ç.) sipas vendimit nr. 2276/2011, i cili përbën “gjë të gjykuar”, për rrjedhojë është i detyrueshëm për palët ndërgjyqëse dhe për gjykatat, sipas nenit 451/a të KPC-së. Vendimi, krahas së drejtës të të paditurit P.P. për të qëndruar në banesë deri në momentin e kthimit të shumës, përmban edhe detyrimin e tij për lirim të banesës nga ai moment. Vënia në ekzekutim e urdhrat të ekzekutimit nga kreditorja F.M.(Ç.) është bërë në referim të nenit 515 të KPC-së. Në bazë të nenit 341 të KC-së, trashëgimtarët ligjorë kanë shlyer detyrimin financiar personal të trashëgimlënësës M.P.(Ç.). Me vendimin e formës së prerë nr. 766/2012 janë pranuar e njohur gjyqësisht të gjithë trashëgimtarët e M.P.(Ç.) edhe nga paditësi P.P., i cili ka pohuar

në gjykim që të gjithë trashëgimtarët e M.P.(Ç.) duhet të shlyenin në favor të tij detyrimin financiar personal të trashëgimtarëve, pohime këto të pranuar në vendimin e formës së prerë me fuqinë e “gjësë së gjykuar”. Për shkak se trashëgimtarët ligjorë kanë marrë përsipër dhe shlyer tashmë të gjithë detyrimin trashëgimor universal të M.P.(Ç.), kanë fituar juridikisht edhe të drejtën trashëgimore për të gjithë pasurinë e së ndjerës. Pretendimi i shtetasit P.P. si trashëgimtar testamentar ka rënë në dekadencë që në mars të vitit 2012, pas vendimit të formës së prerë nr. 766/2012, ku ai ka ngritur pretendime në procesin gjyqësor vetëm si blerës në mirëbesim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Sipas nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare vendoset kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur. Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja është bërë edhe më parë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë, mbi ankimin kushtetues të paraqitur nga pala paditëse në procesin gjyqësor, shtetasi M.Ç., me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 00-2025-609, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me atë ankim kushtetues, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 209, datë 29.07.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

17. Kolegji vëren, fillimisht, se as trashëgimlënësja F.M.(Ç.), as trashëgimtarët e saj, përfshirë kërkuesen, nuk kanë qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetuese, i cili është vënë në lëvizje vetëm mbi bazën e padisë së shtetasit M.Ç. Megjithatë, në ankimin kushtetues në shqyrtim, kërkuesja, në cilësinë e trashëgimtares ligjore të shtetasit F.M.(Ç.), ka parashtruar të njëjtat shkaqe që janë parashtruar edhe në ankimin kushtetues të paraqitur nga shtetasi M.Ç., konkretisht për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të: i) fuqisë së “gjësë së gjykuar” të vendimit nr. 766/2012 dhe të drejtat që burojnë prej tij për trashëgimtarët e trashëgimlënësës M.P.(Ç.); ii) mosthirrjes në gjykim të trashëgimtarëve të shtetasit F.M.(Ç.) (ku bën pjesë edhe kërkuesja), që kanë fituar të drejtat e njohura sipas vendimit nr. 766/2012, çka përbën cenim të procesit për shkak të mosformimit drejt të ndërgjyqësisë lidhur me parimin e kontradiktoritetit në gjykim dhe të barazisë së armëve; iii) keqzbatimit dhe keqinterpretimit të vendimit unifikues nr. 19/2002 dhe të nenit 349 të KC-së në raport me pasurinë e trashëguar e për më tepër të regjistruar në regjistrin hipotekar dhe mosushtrimit të funksionit të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, pavarësisht se gjykatat e faktit kanë dhënë dy vendime diametralisht të kundërta në lidhje me interpretimin e nenit 377 të KC-së.

18. Në lidhje me këto pretendime, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 209, datë 29.07.2025, ka vlerësuar se ato janë haptazi të pabazuara. Për pretendimin për mosthirrjen në gjykim të të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësës M.Ç.(P.) dhe se gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh të drejtat e fituara me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 766, datë 28.03.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, që i përket procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga P.P. për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, ku në cilësinë e palës së paditur ka qenë edhe F.M.(Ç.), Kolegji ka vlerësuar se ka të bëjë me ndërgjyqësinë në procesin gjyqësor, e cila nga pikëpamja kushtetuese është e lidhur me parimin e kontradiktoritetit në gjykim. Sipas Kolegjit, në rastin konkret, ndërgjyqësia rezulton të jetë formuar sipas vullnetit të vet kërkuesit (shtetasit M.Ç.), si pala që e ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor. Nga ana tjetër, ndonëse nëpërmjet padisë në këtë rast është synuar mbrojtja e së drejtës së trashëgimisë (ligjore) në kuptim të gjerë, në thelb, përmes saj, duke kërkuar pavlefshmërinë e testamentit në favor të palës kundërshtare (të paditurit P.P.), është synuar marrja nga gjykata e një vendimi për vërtetimin e mospasjes ky i fundit të së drejtës së trashëgimisë testamentare nga trashëgimlënësja M.Ç.(P.), çka, për pasojë, do t'i hapte rrugë ose do të konfirmonte zbatimin e trashëgimisë ligjore. Nisur nga kjo, sikurse ligji nuk pengon dhe as vendos kufizime, pra nuk imponon krijimin e ndonjë bashkëndërgjyqësie të detyrueshme

(aktive), shtetasi M.Ç. rezulton të ketë zgjedhur të përdorë i vetëm mjetin juridik të padisë dhe, po ashtu, të mos thërrasë në gjykim edhe ata persona që tërhiqnin të njëjtat interesa me të në lidhje me rezultatin e procesit gjyqësor. Në këtë kuptim, sipas Kolegjit të Gjykatës, mosveprimi i gjykatës në krijimin e një ndërgjyqësie të ndryshme nga ajo e përcaktuar nga paditësi nuk duket që të jetë në mosrespektim të ligjit procedural, përveçse, po ashtu, ajo nuk është thirrur për të ndërhyrë në krijimin e një ndërgjyqësie të ndryshme ose për plotësimin e saj, për sa kohë personat që tërhiqnin të njëjtat interesa me paditësin për rezultatin e procesit gjyqësor, kanë zgjedhur të mos i kërkojnë asaj të marrin pjesë në proces me ndonjë cilësi të caktuar procedurale. Për rrjedhojë, procesi gjyqësor i zhvilluar mbi atë ndërgjyqësi, si në rastin konkret, nuk e bën atë të parregullt dhe joligjor, për sa kohë në proces është respektuar kontradiktoriteti dhe palët që tërhiqnin interesa të kundërta kanë pasur mundësi të debatojnë për faktet dhe ligjin, si dhe të paraqesin prova në mbështetje të pretendimeve të tyre (*shih paragrafin 31 të vendimit nr. 209, datë 29.07.2025 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera të ngritura nga shtetasi M.Ç., që në thelb janë të njëjta me ato të ngritura në ankimin individual të kërkueses, ato janë shqyrtuar nga Kolegji i Gjykatës në këndvështrim të *së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, duke i konsideruar, gjithashtu, haptazi të pabazuara. Kolegji ka çmuar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk gjenin mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, pra se nuk kishte në substancë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga M.Ç. është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit, ai ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendimet e tij në përputhje me parashikimet ligjore dhe interpretimi i asaj gjykate nuk rezulton kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm ose me kundërrënie. Po kështu, vetëm fakti se është vendosur mospranimi i rekursit nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt. Për këto arsye, Kolegji ka vlerësuar se pretendimet e kërkuetit M.Ç. në këtë drejtim janë haptazi të pabazuara (*shih paragrafët 41 dhe 42 të vendimit nr. 209, datë 29.07.2025 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më sipër, në situatën që pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual bazohen mbi të njëjtat argumente dhe shkaqe që janë shqyrtuar dhe vlerësuar tashmë nga Gjykata me vendimin e Kolegjit të saj nr. 209, datë 29.07.2025, i cili i ka gjetur haptazi të pabazuara, duke parashtruar edhe shkaqet që e kanë çuar në këtë përfundim, ato nuk mund të merren më në shqyrtim.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.